

STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TREND GROUP AL" SH.P.K.

Ortaku themelues:

BSR Consulting shpk, e regjistruar si person juridik ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 05/06/2018, me numer NUIS L81805054A, me adrese ne , Rruga : "Mine Peza", Hyrja 1, Apartamenti N/3, Zona Kadastrale 8350, Pasuria Nr.4/6-N/3, Tirane.

me deshiren dhe vullnetin e tij te lire, ne perputhje me Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", bie dakort te hartoj kete statut, mbeshtetur ne dispozitat e meposhtme:

SEKSIONI I

Emri, selia, forma juridike, kohezgjatja, objekti veprimtarise

Neni 1

Emertimi tregtar i shoqerise eshte "**Trend Group AL**" shpk. Emertimi tregtar vendoset ne te gjitha aktet dhe dokumentat e shoqerise ne marredheniet me persona te trete, si dhe ne vulen zyrtare te saj.

Neni 2

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Tirane, ne Rruga : "Mine Peza", Hyrja 1, Apartamenti N/3, Zona Kadastrale 8350, Pasuria Nr.4/6-N/3, Tirane.

Selia qendrore e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte saj, nepermjet degeve, filialeve, agjencive apo zyrave te perfaqesimit, kompetencat e te cilave percaktohen nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 3

Shoqeria "**Trend Group AL**" shpk shpk krijohet ne formen e "shoqerise me pergjegjesi te kufizuar" ne te cilen ortaku mbulon personalisht humbjet e



shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara sipas dispozitave qe parashikon ligji.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte me afat te pakufizuar. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe mund te filloje veprimtarine e saj mbas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise tregetare "**Trend Group AL**" shpk eshte: Tregtim, perpunim i produkteve me baze graniti, mermeri, qelqi dhe materiale të tjera të ngjashme për ndërtim dhe mobilim: veprimtari konsulence në lidhje me produktet qe tregton;

SEKSIONI II Kapitali

Neni 6


Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren 100.000 (njeqindmije) leke. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne 1 kuote, me vlere 100.000 (njeqindmije) leke. Nje kuote ka gjithashtu vleren e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte shlyer teresisht nga ortakut themelues i shoqerise ne kete menyre:

-BSR Consulting shpk, me cilesine e ortakut themelues zoteron 100 % te kuotave, ne kapitalin themeltar

Neni 7 Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit themeltar behet si rregull me kontributin e te gjithes ortakeve ne perputhje me pjesmarrjen e tyre ne kete kapital. Zmadhimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme te Ortakeve, me nje kuorum prej tre te katertat (75%) e votave te ortakeve pjesmarres ne asamble. Asamblea do te jete e vlefshme ne prezence te nje kuorumi te vlefshem sipas ligjit.



Zmadhimi i kapitalit, plotesisht apo pjeserisht, me ane te kontributeve ne natyre behet ne perputhje me raportin e vleresimit te ketyre kontributeve te hartuar nga nje ekspert i ngarkuar per kete vleresim dhe te miratuar nga Asambleja me vendim me tre te katertat e votave te ortakeve pjesmarres ne nje kuorum te vlefshem sipas ligjit.

Neni 8 Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit themeltar behet nga Asambleja Jashtezakonshme e Ortakeve, e cila merr vendim me tre te katertat e votave te ortakeve pjesmarres ne nje kuorum te vlefshem sipas ligjit.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne menyre te barabarte, ne perputhje me kuotat e kapitalit qe ata perfaqesojne.

Neni 9 Fitimi dhe kalimi i kuotave te kapitalit

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise, trashegimise, dhurimit, shitblerjes dhe çdo menyre tjeter te parashikuar nga ligji.


Me perjashtim te kalimit te kuotave ne rruge trashegimore, per rastet e tjera kuotat e kapitalit nuk mund t'u kalohen personave te trete pa ju ofruar me pare ortakeve te tjere te shoqerise.

SEKSIONI III Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

Neni 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e thirrur dhe mbledhur ne menyre te ligjshme, perfaqeson teresine e ortakeve te shoqerise.

Vendimet e asamblese te marra ne perputhje me kete Statut dhe legjislacionin tregtar ne teresi jane te detyrueshme per te gjithë ortaket, duke perfshire edhe ata qe mungojne ose jane te perfaqesuar.



Neni 11

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente dhe pergjegjese per marrjen e vendimeve per çeshtjet e meposhtme:

- a. percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emerimin e shkarkimin e administratoreve dhe percaktimin e pagave te tyre;
- d. emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe percaktimin e shperblimit te tyre;
- e. mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te veprimtarise, bilancin vjetor;
- f. zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- g. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h. çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti;

Neni 12

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet rregullisht ne periudha periodike ose ne menyre operative sa here qe gjykohet e nevojshme per zgjidhjen e çeshtjeve te caktuara. Mbledhjet e Asamblese drejtohen nga nje prej ortakeve, i cili caktohet nga asamblea.

Asambleja mblidhet me kerkese te Administratorit, te çdo ortaku qe disponon te pakten 5 % te kuotave ose te ekspertit kontabel te autorizuar, ne rast se ka te tille. Si rregull njoftimi ju behet i ditur ortakeve me poste rekomande ose me poste elektronike, te pakten 7 dite perpara dates se mbledhjes duke percaktuar edhe rendin e dites se mbledhjes.

Neni 13

Secili ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese dhe te votoje te gjitha vendimet e marra duke disponuar nje numer votash te barabarte me kuotat e kapitalit themeltar qe zoteron.

Çdo ortak ka te drejte qe ne mbledhjet e asamblese dhe marrjen e vendimeve, te perfaqesohet: nga nje ortak tjeter; nga nje pjestar i familjes se tij ose nga nje i trete. Ne keto raste duhet leshuar nje autorizim me shkrim.

Ortaket, qe nuk marrin pjese ne mbledhje mund te shprehin mendimin dhe voten e tyre me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.

Ante Bulla

Neni 14
Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur Asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.

Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 15

Ne çdo mbledhje te Asamblese se Ortakeve mbahet procesverbal, i cili firmoset nga drejtuesi i mbledhjes dhe mbajtesi i proces verbalit. Ne kete procesverbal regjistrohen te gjitha çeshtjet e shqyrtuara, permblidhja e debateve, teksti i vendimeve te marra me votim si dhe rezultati i votimit.


Per çeshtjet qe eshte e nevojshme, merret vendim, i cili nenshkruhet nga te gjithë ortaket pjesmarres ne mbledhje.

Neni 16
Marrja e vendimeve

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos me tri te katertat e votave te ortakeve qe realizojne kuorumin e vlefshem, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise apo çeshtje te tjera qe ligji kerkon shumice te cilesuar.

Per çeshtjet e tjera, Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres, qe realizojne kuorumin e vlefshem.

Per rastet qe nuk parashikohen ne statut zbatohet kuorumi i parashikuar per çeshtjen konkrete ne legjislacionin tregtar.



SEKSIONI IV
Administrimi i Shoqerise

Neni 17

Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore, te cilet edhe mund te mos jene ortake ne shoqeri. Nese Asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkarisht shoqerine, ne perputhje me kompetencat dhe pergjegjesite qe ju cakton Asambleja.

Emerimi dhe shkarkimi i administratorit behet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumicen e zakonshme.

Administratoret emerohen per nje mandat 5 vjeçar me te drejten riemerimi.

Ne momentin e hartimit te ketij Statuti, Administrator i Shoqerise **"Trend Group AL"** shpk eshte Z. Antonino Barcella me afat 5 vjetor.

Neni 18

Kompetencat dhe pergjegjesite

Administratoret kane te gjitha kompetencat qe i percakton ligji per te administruar shoqerine, per te vepruar ne emer te saj ne marredhenie me persona te trete ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njeh shprehimisht Asamblese se Ortakeve.

Administratoret kryejne personalisht veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise. Me akt te veçante, Administratoret mund t'i delegojne kryerjen e veprimeve te caktuara personave te trete brenda shoqerise.


Kompetencat dhe detyrat e administratorëve mund te percaktohen ne menyre te detajuar me akte te Asamblese se Ortakeve.

Administratoret jane pergjegjes ndaj shoqerise ose personave te trete per shkelje te akteve ligjore, shkelje te dispozitave te statutit, ose per veprime te gabuara te kryera gjate administrimit te shoqerise, te cilat kane sjelle pasoja te renda.

Neni 19

Marreveshjet e ndaluara

Administratoreve ose ortakeve ne menyre individuale nuk ju lejohet te kontraktojne ne çfaredo forme ne shoqeri, te marrin hua nga shoqeria, te japin hua ne favor te personave te trete si edhe te garantojne ne emer te shoqerise angazhimet ndaj te



treteve. Keto lloj kontratash apo marreveshjesh jane te vlefshme vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas percaktimeve dhe procedurave qe parashikon ligji.

SEKSIONI V Fondet dhe bilancet e shoqerise

Neni 20

Shoqeria per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon dhe disponon fondet e nevojshme, perfshire fondin rezerve dhe fonde te tjera per zhvillim. Perberja, madhesia, burimet e krijimit dhe perdorimi i çdo fondi ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, vendosen nga Asambleja e Ortakeve duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Te gjitha detyrimet qe mund te lindin gjate aktivitetit te shoqerise perballohen nga fondet perkatese.

Neni 21


Veprimtaria dhe viti financiar i shoqerise mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Ne mbyllje te vitit financiar, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, shoqeria harton dhe paraqet per miratim ne organet tatimore, bilancet financiare.

Administratoret hartojne raportin mbi administrimin, gjendjen financiare, llogarite vjetore dhe inventaret e shoqerise, te cilat ja paraqesin per miratim Asamblese se Ortakeve brenda 6 mujorit te pare te viti pasardhes.

Neni 22

Nga fitimet qe rezultojne pas miratimit te bilancit pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme, humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me vlere jo me pak 1/20 e fitimit, e cila destinohet per krijimin e fondit rezerve qe quhet "rezerva e domosdoshme". Ky fond duhet te jete jo me i vogel se 1/10 e kapitalit themeltar.

Pjesa tjetere e fitimit perdoret sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.



Neni 23
Eksperti kontabel i autorizuar

Per kontrollin e llogarive, shoqeria mund te caktoje nje ose me shume eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se Ortakeve sipas kuorunit te percaktuar nga ligji. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrueshem per rastet e parashikuara ne ligj.

SEKSIONI VI
Mbarimi dhe likujdimi i Shoqerise

Neni 24

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast se nuk eshte e mundur te realizohet objekti i veprimtarise se Shoqerise, ne rast se kjo veprimtari rezulton me humbje te vazhdueshme ose ne raste te tjera qe parashikon ligji.

Neni 25


Kur vendoset mbyllja e aktivitetit te shoqerise, ne çfaredo kohe dhe per çfaredo arsye, me vendim te Asamblese se Ortakeve qe perfaqesojne me shume se gjysmen e kuotave ne kapitalin themeltar, emerohet nje ose me shume likujdatore per te ndjekur dhe perfunduar procedurat e likujdimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne perfundim te procedurave te likujdimit, pasuria e Shoqerise qe mbetet pas shlyerjes se te gjitha detyrimeve ndaj te treteve, do te shperndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

SEKSIONI VII
Dispozita te fundit

Neni 26

Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen rregullat dhe dispozitat e parashikuara ne Ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin shqiptar ne teresi.




Neni 27

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin, per zbatimin dhe/ose interpretimin e ketij statuti, aktit te themelimit apo akteve te tjera te shoqerise, midis ortakeve dhe shoqerise, midis ortakeve dhe administratoreve si dhe midis vete ortakeve do te zgjidhen me mirekuptim midis tyre, por ne rast se nje gje e tille do te behet e pamundur, secila pale ka te drejte t'i drejtohet per zgjidhje Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

**ORTAKU
E SHOQERISE TREGETARE
"TREND GROUP AL" SHPK**

**BSR Consulting shpk
Perfaqesuar nga Administratori
Antonino BARCELLA**



Tirane me: 19/09/2019